



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
QENDRA PËR ZHVILLIM TË KARRIERËS

MUNDËSI PËR PUNË VULLNETARË NË QZHK

Qendra për Zhvillim të Karrierës e Universitetit të Prishtinës është zyre e Administratës Qëndrore të UP-së që funksionon që nga viti 2007. Ofron shërbime të edukimit dhe udhëzimit në karrierë për studentët dhe të diplomuarit e UP-së. Organizon aktivitete të shumta që kanë për qëllim përgatitjen e studentëve për punësim dhe ndëlidhjen e tyre me tregun e punës.

Duke u bërë pjesë e stafit tonë, përveç që mësoni më shumë për profesionin e këshilltarit për karrierë, ju zhvilloni aftësitë tuaja administrative dhe organizative të cilat ju ndihmojnë të punësoheni më lehtë. QZHK ka rrjet të gjërë kompanish me të cilat bashkëpunon andaj keni mundësinë të takoni shumë përfaqësues të kompanive dhe të prezantoni vetveten e aftësitë tuaja.

Hape derën e mundësive. Bëhu pjesë e stafit tonë!

Qendra për Zhvillim të Karrierës e Universitetit të Prishtinës ju fton të aplikoni për pozita të lira për punë vullnetare për periudhën tremujore (10 orë në javë). Këto janë pozitat e lira:

- Ndihmës administrator i platformës "e-Karriera"
- Dizajner i materialeve promovuese
- Ndihmës trajner
- Ndihmës në marrëdhënie me publikun

Të interesuarit ftohen të dërgojnë CV-në në emailin qzhk@uni-pr.edu duke cekur në subject të emailit pozitën për të cilën aplikojnë.

Qendra për Zhvillim të Karrierës
Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"
Adresa: Biblioteka Kombëtare e Kosovës
qzhk@uni-pr.edu
ekarriera.uni-pr.edu
Tel: 038/ 248 925
248 926





UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA" QENDRA PËR ZHVILLIM TË KARRIERËS



E-KARRIERA

PLATFORMA E-KARRIERA NË SEMS

Kyçu në eKarriera

ekarriera.uni-pr.edu

Platforma "e-Karriera" ju mundëson:

- Shpalljen e vendeve të lira të punës
- Promovimin e programit të praktikës
- Ndërlidhjen me studentët
- Publikimi i artikujve rreth kritereve të tregut të punës

Qendra për Zhvillim të Karrierës e Universitetit të Prishtinës ofron falas për institucionet publike dhe kompanitë vendore e ndërkombëtare mundësinë e promovimit të mundësive për studentë dhe të diplomuarit përmes shpalljes së njoftimeve për vende të lira të punës, punëve me honorar dhe praktikës për studentë, prezantimin e kompanive dhe promovimin e mundësive për punësim dhe punë praktike në institucionin përkatës si dhe ndërlidhjen me studentë dhe të diplomuarit e Universitetit të Prishtinës në platformën "e-Karriera".

Si të krijoni profilin e kompanisë tuaj në e-Karriera?

Dërgoni kërkesën për profil në emailin gzhk@uni-pr.edu. Kërkesës duhet t'i bashkëngjitet logoja e institucionit dhe përshkrimi mbi profilin, shërbimet dhe mundësitë që ky institucion ofron për angazhimin e studentëve në praktikë dhe punësim, mundësi trajnimi, kurse të gjuhëve, etj. Pasi të jetë krijuar profili juaj, keni mundësi të postoni shpalljet që dëshironi t'i ndani me studentët dhe të diplomuarit e Universitetit të Prishtinës. Në platformën "e-Karriera" kanë qasje të gjithë studentët dhe të diplomuarit e UP-së për të lexuar shpalljet tuaja.

Qendra për Zhvillim të Karrierës
Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"
Adresa: Biblioteka Kombëtare e Kosovës
gzhk@uni-pr.edu
ekarriera.uni-pr.edu
Tel: 038/ 248 925
248 926





UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA" QENDRA PËR ZHVILLIM TË KARRIERËS



E-KARRIERA

PLATFORMA E-KARRIERA NË SEMS

Kyçu në **eKarriera**

SEMS ID
Fjalëkalimi
KYÇU

ekarriera.uni-pr.edu

Platforma "e-Karriera" ju mundëson të:

- Krijoni Cv
- Informata rreth trajnimeve
- Informata rreth aktiviteteve
- Aplikoni Online

"e-Karriera" është platformë digjitale e Qendrës për Zhvillim të Karrierës në Universitetin e Prishtinës për informim dhe udhëzim në karrierë të studentëve të UP-së. Kjo platformë, e cila u ofron studentëve mundësi informimi për ngjarje të ndryshme dhe shpallje pune, mundësi aplikimi për pjesëmarrje në trajnime dhe aktivitete të ndryshme, përpilimin e CV-së dhe letrës motivuese si dhe njohjen e profileve të ndryshme të kompanive, ku studentët mund të punësohen në të ardhmen. Kjo platformë është në shërbim të të gjithë studentëve të Universitetit të Prishtinës dhe punëdhënësve, përmes ueb faqes: ekarriera.uni-pr.edu

Pasi të keni vizituar ueb faqen ekarriera.uni-pr.edu:

- Vendorsi si USERNAME numrin e SEMS ID-së tuaj, dhe
- Fjalëkalimin e njëjtë si në SEMS

Platforma "e-Karriera" ju lehtëson procesin e kërkimit të punës.

Qendra për Zhvillim të Karrierës
Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"
Adresa: Biblioteka Kombëtare e Kosovës
qzhk@uni-pr.edu
ekarriera.uni-pr.edu
Tel: 038/ 248 925
248 926

